



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.380/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Ramush Bardiqi dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Fushë Kosovë, të paraqitur kundër subjektit politik, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), Anr.380/2025, e datës 05.02.2025.

II. Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 2.000,00 € (Dymijë) Euro.

III. Detyrohet Subjekti Politik, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Komuna Pejë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 05.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër Anr.380/2025, nga Subjekti Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), kundër subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) më të cilën pretendohet se më datë 3 shkurt në orën 20:25 min në rrjetin social në facebook, kandidati për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik IRDK z. Fridon Lala postoi në profilin e tij, fjalinë apo mbishkrimin "Hoodi plot kurtha me nxon pacovin" të shoqëruar me një fotografi, ku vërehet Z. Lala me një grup të mbështetësve të tij. Duke qenë se subjekti politik IRDK, të vetmin kundërshtar politik ka subjektin tonë politik PLE, kuptohet se në këtë kohë fushate, sikurse edhe herëve të tjera, fjalia e sipërpërmendur ka të bëjë kundër nesh Shprehja "me nxon pacovin" sikurse në të kaluarën është përdorur kundër kryetarit të subjektit politik PLE, z. Veton Berisha, i cili në pamje nuk është i gjatë nga pamja, por trup shkurtër, duke e krahasuar me "pacovin" (Iloj miu, brejtës). Kjo gjuhë fyese, denigruese e cila tashmë është bërë e shpeshtë nga subjekti politik IRDK është e papranueshme, duke shtuar faktin këtu që është publikuar në rrjetin social Facebook duke

marrë qindra "like" dhe dhjetëra komente nga përkrahësit dhe mbështetësit e këtij subjekti politik. Për më tepër, përkrahje të kësaj gjuhe fyese dhe denigruese, kjo fjali ka marrë edhe nga kryetari i subjekti politik IRDK, z. Elbert Krasniqi, sipas dëshmisë së bashkëngjitur në këtë ankesë. Gjithashtu, në pjesën e komenteve të kësaj shprehje, vërehet se një mbështetës i subjektit politik IRDK, m emrin në facebook Muhamet Mujaj, shkruan "Kogja "helm "je per do brejtsa Frido " (Frido është përdorur si shkurtesë për Fridon Lalën, autorin e shkrimit).

Në përgjigjen në ankesë të datës 06.02.2025 subjekti politik IRDK ka theksuar se shprehja "pacov" nuk i është dedikuar dhe as nuk është përdorur me konotacion fyjes ndaj kryetarit të PLE Veton Berisha apo ndonjë oponenti tjetër politik dhe shprehja "pacov" nuk mund të nxisë urrejtje dhe as të provokojë dhunë ashtu që nuk përkon me pretendimin në të cilin është thirrur ankuesi sepse shprehja "Hoodi plot kurtha me nxon pacovin" ka të bëjë me tepër me shprehje krahinore të komunitetit në Gjakovë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, ankesën dhe përgjigjen në ankesë, vëren se ankesa është e bazuar.

Paneli, pas shikimit të provave materiale, të bashkëngjitura në ankesë, ku konstatohet se kandidati për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik IRDK, Fridon Lala postoi në profilin e tij në rrjetin social, fjalinë apo mbishkrimin "Hoodi plot kurtha me nxon pacovin" të shoqëruar me një fotografi, ku vërehet kandidati në fjalë me një grup të mbështetësve të tij, ka përdorur gjuhë fyese dhe denigruese duke nxitur urrejtje ndaj këtij subjekti politik.

Paneli, gjeti se pretendimet e Subjektit Politik PLE, janë të bazuara, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisë si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë"*.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj Paneli gjeti se gjuha, përkatësisht postimi i përdorur kundër subjektit politik PLE, është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së. Në këtë rast është marrë për bazë kontekstin dhe qëllimin për të cilin është përdorur gjuha ndaj një subjekti politik në garë, faktin që deklaratat janë bërë në rrjetin social facebook, andaj sipas Panelit përdorimi i gjuhës së tillë ndaj kundërshtarëve politikë ka për qëllim ofendimin, denigrimin dhe njëherit shihen si shprehje me ngjyrimë përçmues ose nënvlerësuese. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet

politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse, andaj sipas Panelit përdorimi i kësaj gjuhe në këtë rast konsiderohet si përkeqësim i klimës në të cilën duhet të zhvillohet gara zgjedhore dhe njëherit mund të rrisë tensione mes subjekteve politike.

Pretendimet në përgjigje në ankesë të subjektit politik IRDK, ku ka theksuar se shprehja “pacov” nuk i është dedikuar dhe as nuk është përdorur me konotacion fyese ndaj kryetarit të PLE Veton Berisha, apo ndonjë oponenti tjetër politik dhe shprehja “pacov” nuk mund të nxisë urrejtje dhe as të provokojë dhunë ashtu që nuk përkon me pretendimin në të cilin është thirrur ankuesi sepse shprehja “Hoodi plot kurtha me nxon pacovin” ka të bëjë me tepër me shprehje krahinore të komunitetit në Gjakovë, paneli nuk e mori për bazë për të vendosur ndryshe nga ajo që është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi, për faktin se pikërisht kjo shprehje është përdorur me qëllime fyese, e nënçmuese kundër kundërshtarit politik në këtë rast ankuesit.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysht të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje si dhe faktin që shkelja nga ky subjekt është përsëritur në këtë proces zgjedhor, njëherit subjekti politikë në fjalë nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes buxhetit të Republikës së Kosovës.

Prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesën e parashtruar e konsideron të bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera të përgjigjes në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 pika 1.11),, nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr.380/2025, datë 07.02.2025

Kryesues i Panelit
Hajriz Hoti



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.